



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, konformë Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.03.2005 merr

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E KRITEREVE BAZË PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRDORIMIT TË HAPSIRAVE BANESORE 01. NR. 35-2425, TË DT. 10.09.2004

I

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapsirave banesore 01. nr. 35-2425, të dt. 10.09.2004, dhe atë:

Neni 9

Pas fjalëve “në vit” duhet të jetë:

Dhënien e hapësirës publike në shfrytëzim dhe pagesën paraprake, sipas par. 1. të këtij neni, me Aktvendim, do ta bëjë Drejtorati i Shërbimeve Publike, i Transportit, i Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore.

Sipërfaqja e nevojshme për çasje të lokalit, sipas kriterëve urb-arkitektonike, duke u bazuar në planet ekzistuese dhe në ato të rejat (planet rregullative për çdo rrugë apo lagje) do të mirren parasysh dhe do të miratohen gjatë dhënjes së lejes urbanistike në përputhshmëri me destinimin e ri të lokalit.

Pa prezentimin e Aktvendimit për dhënie në shfrytëzim të hapësirës publike dhe pronës se është bërë pagesa për kompensimin e shumës së cekur, sipas al 1. të këtij neni, nuk mund të jepet leja përkatëse në dorëzim.

Ky propozim është bërë me qëllim të implementimit të Vendimit me të cilin do të bëhej ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapsirave banesore në ato afariste.

II

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr.31-7333 dt. 05.04.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri